



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 3727 Prot.

Tiranë, më 08.07 2024

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”) në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik “CFO PHARMA” shpk me NIPT K22305002U, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim në procedurat e mëposhtme të prokurimit:

- “Blerje medikamente”, me vlerë 1.892.301 lekë, zhvilluar nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, në datë 29.12.2023;
- “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”, me vlerë 700.000 lekë, zhvilluar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has, në datë 30.01.2024.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): “CFO PHARMA” shpk me NIPT K22305002U, me adresë: Rruga Pavarësia, Ndërtesa Nr. 1, Mëzes, Kashar, Tiranë.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik “CFO PHARMA” shpk, ka nisur, mbi bazën e informacionit të dërguar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona, ku rezulton se, subjekti “CFO PHARMA” pas inspektimeve të kryera nga ky institucion, ka marrë masë administrative “gjobë”, në shumën 200.000 lekë, për shkelje të legjislacionit të punës.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 65 datë 08.07 2024, APP ka vendosur të përjashtojë për 6 (gjashtë) muaj, operatorin ekonomik “CFO PHARMA” shpk me NIPT K22305002U, nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.